



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2847 Prot.

Roskovec, më 01.04 2021

VENDIM

NR. 14 .DATË 31.03 .2021

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË  
ROSKOVEC PËR VITIN 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike” neni 43 i tij, ju paraqesim, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e Raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
- 2- Bashkëlidhur këtij vendimi “Raporti i punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
- 3- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2252 Prot.

Roskovec ,më 23.03 .2021

**Lënda: Raport për punën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2020**

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Roskovec i kryen funksionet e tij duke u mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe Rregulloret e brendshme të funksionimit të këshillit bashkiak.Këshilli ka miratuar 9 Komisione të Përherëshme të cilët mbledhen sipas rasteve që paraqiten në këshill.

Gjatë vitit 2020 i cili ishte edhe një vit i vështirë për shkak të pandemisë prej virusit Covid 19, këshilli është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin një vëmendje më të madhe për një shërbim cilësor dhe sa më afër komunitetit.Në mbledhjet e këshillit janë trajtuar vendime të rëndësishme, që kishin një impakt të fuqishëm në lidhje me përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në qytet dhe në fshatra.Prioritare kanë qënë vendimet që i kushtoheshin zgjidhjes së problemeve për familjet në nevojë dhe ato me probleme të thella sociale.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë miratuar gjithësej 101 (një qind e një) vendime në Këshillin e Bashkisë Roskovec.

Janë organizuar dhe zhvilluar 12 mbledhje këshilli të cilat kanë qënë të gjitha mbledhje të hapura për publikun.Njoftimet e mbledhjeve, publikimi e afishimi i tyre është bërë sipas kriterëve që përcakton ligji.

Vetëm 2 (dy) Vendime nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier,dhe në bazë të procedurës ligjore këto vendime janë anuluar po me vendim këshilli.Bazuar në shkresën Nr.386 datë 24.04.2020 të Prefektit të Qarkut Fier,vlen për tu theksuar se duke filluar nga muaji Prill e në vazhdim në Prefekturën e Qarkut Fier kemi dërguar për konfirmim ligjor vetëm aktet me karakter normativ,pasi në bazë të ligjit Nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 16 i tij,Prefekti

i Qarkut si kompetencë kryesore në lidhje me NJVQV-të ka verifikimin ligjor të akteve normative. Vendimet me karakter individual dhe kolektiv pas miratimit në Këshillin e Bashkisë, zbardhen brenda afateve ligjore nga Sekretaria e Këshillit dhe hyjnë në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6 i tij. Të gjitha vendimet e miratuara sipas karakterit dhe objektit të tyre u janë shpërndarë administratës së bashkisë për zbatim.

Nisur nga karakteri i vendimeve pjesën më të madhe të vendimeve të miratuara për vitin 2020 e zënë vendimet për problemet sociale dhe familjeve në nevojë, të ndjekura nga vendimet për problemet financiare, për infrastrukturën dhe investime, vendime të taksave dhe tarifave si dhe ndryshime të tyre, vendime të miratimit të rregulloreve, vendime të përditësimit të listave të inventareve për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative, si dhe vendime të problematikave të ndryshme.

Ndër vendimet më të rëndësishme të miratuara gjatë këtij viti vlen të përmenden disa prej tyre si më poshtë :

- Dhënia e ndihmës ushqimore e familjeve në nevojë gjatë periudhës së karantinës nga Covid-19. Me paketa ushqimore u erdhëm në ndihmë familjeve të cilat ishin në kushte tejet të vështira ekonomike.
- Vendime të tjera të rëndësishme janë: “Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec për familjet që kanë mbetur të pastreha, sipas zbatimit të programit “Banesë me kosto të ulët”. Janë 5 familje, 3 prej të cilave i përkasin komunitetit Rom, të cilët kanë përfutur nga një apartament nga këto vendime dhe sipas programit “Banesë me kosto të ulët”, duke zgjidhur në këtë mënyrë problemin e tyre si të pastrehë.
- Janë miratuar 116 kërkesa nga individë/familje të cilët aplikojnë për cdo program social strehimi. Nisur nga këto kërkesa është miratuar Marrëveshja e Bashkëpunimit me Entin e Banesave “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”. Kjo marrëveshje ndërmjet Bashkisë dhe Entit të Banesave do i japi zgjidhje problemit të strehimit për familjet të cilat janë të pastreha. Gjithashtu është edhe një mundësi shumë e mirë për familjet e reja të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë një banesë.
- Nje tjetër vendim me shumë rëndësi për komunitetin është edhe “Miratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec” e cila i hap rrugë urbanizimit dhe zhvillimit të gjithë territorit të bashkisë tonë.
- Gjatë këtij viti janë miratuar 5 Rregullore, 4 prej tyre janë Rregullore të Këshillit Bashkiak dhe 1 Rregullore e Funkcionimit të Tregut Publik të Bashkisë Roskovec.
- Rregulloret e këshillit përcaktojnë rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Këshillit Bashkiak Roskovec, procedurën e miratimit të vendimeve të Këshillit, të veprimtarisë vendimarrëse, përfaqësuese dhe mbikqyrëse të Këshillit, monitorimin e procesit të zbatimit të vendimeve të Këshillit, si dhe marrëdhëniet e Këshillit me Kryetarin dhe administratën e Bashkisë, me institucionet agjencitë qeveritare qendrore dhe rajonale, komunitetin, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe strukturat komunitare, përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe realizimin e detyrave të dhëna me ligj.



- Me vendimin e miratuar “Krijimi i Muzeut Historik Roskovec”,i shtohet qytetit tonë një objekt me vlera të rëndësishme historike.Krijimi i këtij Muzeu Historik do të jetë një atraksion historik dhe turistik,në evidentimin e traditës dhe vlerave më të mira të zonës tonë ndër vite.

Gjatë periudhës së pandemisë,kur vendi ynë ishte në karantinë,në muajin Mars,Këshilli i Bashkisë zhvilloi mbledhje online në platformën skype.Kjo mënyrë e zhvillimit të mbledhjes ishte një risi në punën e këshillit,dhe një praktikë shumë e mirë për ti ardhur në ndihmë komunitetit me vendimmarrje edhe në situata të vështira si pandemia nga covid-19.

Një pjesë shumë e rëndësishme gjatë zhvillimit të mbledhjeve të këshillit,është edhe hapsira kohore që i kushtohet komunitetit pjesmarrës në mbledhje.Një pikë e vecantë e rendit të ditës i kushtohet vecanërisht diskutimeve dhe komenteve të qytetarëve,gjatë së cilës dëgjohen problemet dhe hallet e tyre nga këshilli dhe bashkia.

Gjatë vitit 2020 në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta”,këshilltarët kanë marr pjesë në disa trajnime dhe seminare,në të cilat kanë fituar njohuri sesi duhet të zbatohen dhe implementohen në praktikë rregulloret e këshillit bashkiak të miratuara po gjatë këtij viti,rolin përfaqësues të këshillit në dëgjesat publike,si dhe njohuri sesi këshilltarët ta kenë më të lehtë leximin e tabelave buxhetore.

Nga sa më sipër vlen të theksohet se Këshilli Bashkiak ka trajtuar dhe i ka dhënë zgjidhje një game të gjerë problematikash të komunitetit tonë në fusha të ndryshme si :për të ardhurat e veta,për fondet buxhetore,për ndihmat ekonomike,për shërbime ndaj komunitetit,investime ndaj komunitetit etj..Zgjidhja e këtyre problemeve vjen si rezultat i një bashkëpunimi shumë të mirë me Ekzekutivin dhe administratën e Bashkisë Roskovec,të cilët kanë si objektiv të përbashkët zgjidhjen në kohë dhe sipas ligjit gjithë shqetësimet dhe problematikat e komunitetit të Bashkisë Roskovec.

Të gjitha vendimet e këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

Këshilli i Bashkisë Roskovec do të vazhdojë të punojë me përkushtim dhe përgjegjshmëri gjithmonë në shërbim të komunitetit.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!*

Konceptoi:Sekretar i Këshillit  
Arlinda Hajdini

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**

